

Viti XIII, numri 7/korrik 2009

FOREVER



HUNGARY / ALBANIA / BOSNIA AND HERZEGOVINA / CROATIA / MONTENEGRO / SERBIA / SLOVENIA



Holiday Rally
2-4. 10. 2009 Poreč



E ardhmja

Siç e vutë re edhe në kopertinën e revistës, Tani festojmë publikimin e 100-të të revistës Forever International. Duke parë 8 vitet e kaluara jam shumë krenar për atë që përbëjnë këto publikime. Gjatë kësaj periudhe çdo muaj ju treguam bazat stabile mbi të cilat ndërtojmë, si u zgjeruam në botë, si nxorrëm në treg produktet e reja të mrekullueshme me të cilat ndryshuam jetën e miliona njerëzve. Dhe prapë, me këto 100 publikime, arritëm t'ju tregojmë vetëm një pjesë të vogël të historisë së FLP-s. Revistën Forever e nxjerrim në shtyp çdo muaj, kështu që mund t'i festojmë me dinjitet rezultatet Tuaja të shkëlqyera, Distributorë të dashur. Me ndihmën e saj ndamë me Ju produktet tona të shkëlqyera dhe ju ofruam trainime speciale në lidhje me mundësinë e biznesit. Shpresojmë se këto kanë patur efekt me të vërtetë motivues në biznesin tuaj.

Kaq mjafton rreth të kaluarës. Mezi po pres të lexoj 100 publikimet e ardhshme të revistës sonë, sepse jam i sigurt se do të bëjnë fjalë rreth sukseseve të vazhdueshme të Forever-it në gjithë botën. Meqë po flasim rreth festimit, dalëngadalë po afron Super Rally! Mezi po pres të takohem me mijëra distributorë të kualifikuar në Dallas! Duhet t'ju them se shtabi i Home Office punon në mënyrë të palodhur në organizimin e Super Rally-t më të madh të kohërave. Edhe JU bëni gjithçka!

Fakti që Super Rally është kaq afër, do të thotë edhe se ndodhemi në mes të vitit. Kjo është periudha më e mirë për të bërë një pasqyrë dhe të shikojmë se ku ndodhemi në realizimin e qëllimeve të përcaktuara në janar. Pavarësisht nga problemet ekonomike dhe recesionit me përmasa botërore, tek Forever presim një vit të mbarë. Edhe ne dëshirojmë ta bëjmë një vit TË SHKËLQYER! Si mund ta bëjmë të tillë? Duke parë qëllimet e janarit, duke analizuar ato të arritura deri tani dhe duke përcaktuar se çfarë duhet të plotësojmë gjatë 6 muajve të ardhshëm, së bashku mund t'i realizojmë me siguri qëllimet e përcaktuara.

Njëherë dëgjova se "qëllimet janë ëndrra me kufi kohor". Mua kjo fjali më jepte gjithmonë ndjenjë e nxitimit. Po ju pyes Juve që cilat janë qëllimet tuaja? Ndoshta një makinë e re, pagimi i kredisë së shtëpisë, arsimimi i fëmijëve, arritja e Profit Sharing, të shkoni në pushimet e ëndëruara apo në Super Rally për herë të parë? Për arritjen e qëllimeve tuaja do të keni nevojë për pasion, këmbëngulje dhe pak nxitim gjithashtu, që këto t'ju motivojnë gjatë gjithë vitit. Mos harroni që s'ka rëndësi nëse qëllimet tuaja janë të mëdha apo të vogla, të gjitha mund të arrihen me Forever Living!

REX MAUGHAN

ERDHI VERA!

Me raste moti na gënjen këto kohët e fundit, por pavarësisht nga kjo me të vërtetë ka ardhur vera, periudha e pushimeve dhe shpłodhjes së merituar.

Për shumë prej nesh përbën problem të madh udhëtimi në bregdet apo në vende të tjera të rëndësishme të kontinentit. Por Forever kujdeset rreth atyre që kanë vështirësi materiale dhe që nuk mund t'i zgjidhin dot vetë pushimet e familjes së tyre, prandaj nisi dy programe motivuese, qëllimi i të cilëve është udhëtimi dhe pushimet verore.

Një nga programet tona më të njohura është Rally i Poreçit, i cili u zgjerua në një argëtim dhe mësim prej katër ditësh dhe tre netësh. Mund të kalojmë ditë të bukura në një ambient të mrekullueshëm bregdetar, mund të shijojmë ushqimet e shijshme kroate, mund të njohim monumentet dhe zakonet e tyre popullore.

Këtë kohë mund ta kalojmë jo vetëm në mënyrë të këndshme, por edhe të dobishme, pasi nga mësuesit më të mirë të Europës mund të mësojmë të fshehtat e ndërtimit të rrjetit marketing, si rezultat i të cilës çdo vit me mijëra familje arrijnë në planin marketing të Forever-it "ëndrën" e menaxherit që përbën një nivel tepër të lartë.

Po në këto ditë filloi edhe periudha e kualifikimit të programit motivues të Europës, destinacioni i të cilit sivjet është Londra. Ky qytet është kryeqyteti multikultural i Europës. Me historinë e tij të mrekullueshme, ndërtesat madhështore dhe natyrisht me motin e tij special, jetën muzikore dhe teatrale.

Tani Forever Living Products na fton në një ekskursion të mrekullueshëm në këtë qytet magjeps. Çfarë duhet të bëjmë, çfarë kërkon kompania nga ne për këtë? Në të vërtetë asgjë të veçantë, jo shumë ekstra, vetëm që **çdo ditë** të kryejmë detyrën tonë. Të organizojmë përditë punën tonë rrjetndërtuese, t'i lutemi sponsorëve tanë dhe duke i kryer detyrat tona në bazë të udhëzimeve të tyre t'i plotësojmë kushtet para kufirit kohor. Nëse e bëjmë detyrë të përditshme punën rrjetndërtuese dhe kjo bëhet pjesë e jetës së përditshme, atëherë nuk duhet ta kemi mendjen tek kufiri kohor, nuk na zë paniku në ditët e fundit, nuk duhet të punojmë me nxitim në momentet e fundit, por mund t'i plotësojmë me ritëm të qetë kushtet e nevojshme për arritjen e programeve motivuese.

Dy programet e mbulojnë dhe plotësojnë njëri tjetrin, ata që i plotësojnë me sukses deri në 31 gusht kushtet e Holiday Rally-t, duke e vazhduar këtë punë u përgjigjen thjeshtë edhe kushteve të udhëtitimit për në Londër.

U uroj të gjithëve pushime të këndshme verore, përgatitje të mirë për udhëtim dhe ndërtim të shkëlqyer rrjeti. Përpara FLP Hungari!

DR. SANDOR MILESZ
drejtor gjeneral



Në rrugën e ëndrrave

Shiko tani si ai qëndron aty,
Me siguri në rrugën e suksesit.
Shiko tani edhe atë,
Që merret me të shkuarën.
Shiko tani, këtu është e shkuara,
Këtu do ishte edhe sa vite me radhë.
Por ta dish, kjo është gjë e madhe,
Dhe s'është lojë.

Dhe ata, të shtrenjtët ata,
Që tani na shikojnë me lot në sy.
Ata janë këtu, bashkë me ty,
Të gjithë pas teje me shumë histori.
Sepse ata të besuan ty,
Të dhanë besim gjatë viteve.
Dhe ata të morrën për dore,
Në rrugën e ëndrrave.

Ç'vlerë ka grada, sado serioze të jetë,
Nëse s'ka flakë dhe s'ka buzëqeshje.
Nëse s'ka zjarr dhe pasion,
Nëse s'ka besim brenda teje.
Ngjitu gjithmonë e më lart,
Dhe s'do ketë më hije.

Fati s'është gjithmonë i mirë,
Ka dështim, ka dhuratë të keqe.
Dhe ke frikë, por edhe shpresë,
Dyshon, shkelesh nga të gjithë.
Ndodh që s'ka mëtej,
Se duron më peshën e jetës.
Por ata të marrin për dore,
Në rrugën e ëndrrave.

S'ka rrugë kthimi, aty është maja,
Të qesh poshtë e shkuara krenare.
Digjet zjarri, pasioni,
Gumëzhon besimi brenda teje.
Është e jotja fjala dhe drita,
Dhe është e jota loja.

Kënga me titull **My way** e **Frank Sinatra**-s.



Dymbëdhjeta është numër mistik, ashtu si edhe numri tre e shtatë. Thonë se të sjell fat, edhe në martesë. Ai që ka arritur deri aty ka përpara një të tashme të bukur dhe një të ardhme akoma e më të shkëlqyer. Forever Living Hungary në maj festoi përvjetorin e saj të dymbëdhjetë – përpara shtatë mijë besimtarëve të saj entuziast në Arenën Sportive Laszlo Papp të Budapestit. E bekoftë Zoti!

Prej dymbëdhjetë vitesh – në rrugën e ëndrrave



Success Day i Përvjetorit nisi me shfaqjen që krijoi një atmosferë të bukur të këngëtarit të dasmave **Sandor Liszter** dhe grupit të tij, si dhe kërcimtarëve të **Vadrozsak**, pastaj erdhi shfaqja e **Tibor Elias** ku luajti pjesë të njohura nga vepra muzikore klasike, ndërkohë që të pranishmit në festë e mbushën gjithmonë e më shumë Arenën.

Ata u ndoqën nga shfaqja e veçantë në skenë e dy drejtuesve të programit, pasi nga një pako dhurate përvjetori dolën diamant-safir menaxheri **Miklos Berkics** dhe partnerja e tij tërheqëse, senior menaxherja **Patricia Rusak**, të cilët pasi përshëndetën publikun thirrën në skenë kapitenin, drejtor gjeneralin **Dr. Sandor Milesz**, i cili mbërriti në Arenë me një Roys Roys të bardhë bashkë me gruan e tij **Adrienn**. "Me sa shikoj jemi gjithmonë e më shumë, dhe ne do të ndihmojmë që të jemi edhe më shumë se kaq!" – filloi përshëndetjen e tij të përvjetorit doktor Milesz, pastaj vazhdoi kështu: "Mundësia për përparim është e dhënë, por është shumë e rëndësishme që ta



ndërtojme së bashku biznesin, dhe do ta shikoni që ne do të bëhemi më të mirët në botë!" Mendimet e tij i mbylli me kërkesën: "Ju që jeni tani këtu, më premtoni se do të vini edhe herën tjetër, dhe secili sjell me vete edhe një njeri tjetër! Në rregull? Bëhuni të suksesshëm dhe të pasur! Përpara FLP Hungari!"

Pas kësaj dëgjuam drejtorin operativ të Europës, **Peter Lenkey**-n, i cili në leksionin

e tij plot ndjenja foli rreth kuptimit të biznesit. Tha se në botë punojnë nëntë milion njerëz për sukseset e FLP-s dhe të gjithë kemi si qëllim ndryshimin e jetës sonë.

Ky është një biznes i pastër, me faqe të pastra, ku të dyja palët janë fituese, sepse **Rex Maughan** ka përpunuar një plan biznesi tepër korrekt. Pra bazat i kemi në dorë, por është shumë e rëndësishme që atë që bëjmë, ta bëjmë me kë-

aqësi. Ky është një nga sekretet e suksesit, dhe kështu mund ta ndryshojmë me të vërtetë jetën tonë. "Jam krenar që ndodhem mes jush, dhe më pëlqen të jem me ju!" – tha ai, dhe fjalën e tij e mbylli duke thënë se mundësitë janë të dhëna dhe çelësin e kemi në dorë. "Ju jeni më të mirët, ju jeni profesionistë!"

Disa minuta më vonë publiku i Arenës e ndjeu veten si në një konferencë të vogël

mjekësore, sepse në skenë u shfaq soaring menaxherja **Dr. Edit Revesz Dr. Siklosne**. Në leksionin e saj me nivel të lartë profesional na bëri të qartë mekanizimin e krijimit të disa sëmundjeve, rolin vendimtar të antioksidantëve natyror, metodat e parandalimit, si dhe rolin e ushqimimit të duhur, marrjes së vitaminave dhe mënyrës së duhur të jetesës. Gjithë këtë natyrisht duke rekomanduar





produktet Aloe Vera. Tema vazhdoi me bllokun e soaring menaxheres **Dr. Terezia Samu**, ku sipas zakonit thirri në skenë mjekët dhe kolegët që punojnë në shëndetësi, me të cilët së bashku vlerësuan përvojat me produkte personale dhe të njerëzve që jetojnë përreth tyre.

Pas kësaj erdhi – gjithashtu sipas zakonit – kualifikimi i kampit të madh të **supervisorëve** dhe **asistent menaxherëve**. Pasi u zbraz skena dhe u fikën dritat filloi një film ku një vajzë e një djalë – tashmë të rritur – prezantuan prindërit, jetën e përbashkët, përpjekjet dhe sukseset e

tyre, të cilat ia dinë për nder FLP-s. Pas përfundimit të klipit u dëgjua një duartrokite e madhe kur në skenë u shfaq e preferuara e të gjithëve, diamant menaxherja **Veronika Lomjanski**. Edhe ajo e filloi me një pyetje, të cilës pas një pauze të shkurtër edhe ju përgjigj: “Përse jeni këtu?” –

ishite pyetja, pastaj përgjigjia: “Që të bëjmë para!”.

Kaq e thjeshtë është e gjitha, s’duhet ta ndërlikojmë. Në leksionin e stilit e saj të veçantë kërkoi që secili t’i kushtoj vëmendje sponsorit të vet, sepse nga ai e merr ndihmën e vërtetë. Kurse pretekstet trajtojeni me argu-



mente llogjike, mos theksoni që përse jo, por që përse po. Kurse fëmijët tanë t'i mësojmë të bëjnë para në kohën e duhur, sepse nga kjo do të kenë një jetë stabile dhe të lumtur. Ta shfrytëzojmë mirë kohën dhe t'i përqëndrojmë energjitë tona në ndërtimin e biznesit, të punojmë shumë


dhe suksesi vjen vetë. Pastaj erdhën përsëri kualifikime.

U morr vesh se janë shumë ata që duan **të sundojnë**, shumë njerëz planifikojnë **të blejnë makina**, u rrit numri i **menaxherëve** dhe **menaxherëve drejtues**, si dhe u erdhi radha edhe dhënies së kualifikimeve

Business 20-30-40 dhe **Super Rally** sipas skenarit të njohur. Ka kohë që s'ka patur muzikë drejtpërdrejt, prandaj kjo erdhi si argëtim, madje gjithë pjesëtarët ishin anëtarë të FLP-s dhe rrjetndërtues të zellshëm. Pra në Arenë erdhi një party e vogël me bashkëpunimin e **Dia Biro-s** dhe

Klara Hertelendy-t, si dhe **Andras Banhidyt**, **Zoltan Dando-s** dhe **Leslie Szabo-s**. Pastaj dy drejtuesit e shkëlqyer të programit thirrën në skenë një kokë me të vërtetë të madhe, **Jozsef Szabo-n**.

Njeriun i cili dymbëdhjetë vite më parë e ëndërroi, pastaj dy vjet më vonë e solli në jetë



FLP Hungarinë. „Kur isha fëmijë në Debrecen ëndërroja shumë rreth udhëtimeve të mëdha. Doja të shkoja larg, shumë larg. Por e dini sa ndjenjë e keqe është të ëndërrosh pa para, me xhepin bosh.

Çfarë të bëj, të heq dorë nga ëndrrat e mia?” – shtroi pyetjen safir menaxheri. Pastaj mësuam se ishte tridhjetë e tetë vjeç kur u takua në Gjermani me njeriun i cili i tregoi mundësitë e mëdha që fshihen tek FLP. „S’duhet gjë

tjetër, „veçse” të jesh njeri, të duash të ndihmosh të tjerët!” – ishte nxitja! Kaq është e gjitha. „Hap kutinë, brenda saj fshihet rrugëzgjdhja!” – theksoi. Por duhet të bësh për të, sepse për gjërat serioze duhet të luftosh.

Dhe natyrisht t’i lëshojmë frenat, të mposhtim në radhë të parë ankthet tona. Të mos harrojmë se paraja është vetëm mjet, unë e bëj parand dhe jo paraja mua! Të mos kërkujmë peshkun, por më mirë të mësojmë të peshkojmë,

përfitojmë më shumë me të. „Ky biznes është kaq i mirë, sepse funksionon nga shpirti, ndershmeria dhe pastërtia!” – përfundoi mendimet e tij plot dashuri dhe entuziazëm Jozsef Szabo. Pastaj para skenës erdhi përsëri një makinë lluksoze e bardhë.

Kishte dy pasagjerë, dy drejtuesit e programit. Me sa duket kjo s’ ishte vetëm festë përvjetori, por edhe e shfaqjeve spektakolare. **Attila Gidofalvi** është diamant-safir

menaxher me një të shkuar të konsiderueshme rjetndërtimi, është i dashuruar pas motorave, tregoi një stil të vërtetë, pasi klipi që prezantoi momentet kryesore të jetës së tij të deritanishme kishte si sfond muzikor këngën me titull Kam një ëndërr të grupit ABBA. Për larmi ai u shfaq me makinë flakë të kuqe mes tre motorave përpara dhe dy pas para festuesve që e pritën atë si një mbret. Pastaj foli seriozisht. Të gjithë kërkojnë sekretin



e suksesit apo disfatës. Nuk duhet kërkuar, sekreti jemi vetë ne, ai fshihet në personalitetin tonë. Të gjithë flasin rreth krizës, por po ua tregoj: krizë apo jo, bonusat e mi në FLP u dyfishuan. Tre gjërat më të rëndësishme janë të dish se çfarë dëshiron, cili je dhe trego gjithmonë vetveten, mos kërko të jesh njeri tjetër, sepse vetëm kështu je i besueshëm.

Të duam të bëhemi dikush, të arrijmë rezultate që të na e mësojnë emrin. Të duam ta jetojmë jetën që dëshirojmë me të vërtetë, por të jemi të gatshëm të punojmë për ëndrrat tona! FLP është një mundësi e shkëlqyer për këtë, vetëm duhet shfrytëzuar, pasi kemi vetëm një jetë. Në ç'mënyrë? Të shikojmë ata që janë të suksesshëm dhe të mësojmë prej tyre. Beso në vetvete, duaji produktet dhe ndjeje mirë veten. Ku dëshiron të përkasësh, mes atyre që ndryshojnë botën? Po? Atëherë të ndryshojmë mënyrën e të menduarit dhe do të kemi sukses! Pas leksionit interesant, natyrisht të prekur dëgjuam këngën me titull My way të Frank Sinatra-s, ndërkohë që këngëtari Lui tekstin hungarisht të shkruar për këtë rast ia dedikoi Attila Gidofalvi-t.

Pas një pushimi të shkurtër publiku, në radhët e të cilit ishte edhe Dr. Sandor Milesz, u argëtua nga **grupi Android**, pastaj nga këngët klasike të këngëtarit të grupit Edda, **Attila Pataky**. Radha e lektorëve u mbyll nga diamant menaxherja e dyfishtë më e









shpejtë në botë **Katrin Bajri** që kishte ardhur nga Gjermania. Me udhëzimet e saj i qetësoi të gjithë: Ndodhemi në vend të shkëlqyer, sepse FLP është një nga bizneset më të mira, më premtuese, më korrekte dhe me zhvillimin më dinamik në botë. Për këtë kanë merita të veçanta hungarezët e shkëlqyer!

Një copë qymyri i zi dhe i papërpunuar mund të bëhet diamant nëse përfundon në duar të mira. Asnjëri nuk lind

drejtues, por bëhet i tillë me punë. Drejtuesit e shikojnë çdo ditë të ardhmen, sepse e dinë çfarë dëshirojnë. Të duam të bëhemi diamant dhe kemi për t'u bërë të tillë! Në mbyllje të ditës skena u pushtua nga **asistent supervizorët**, pastaj të gjithë u nisën për në shtëpi me mendimin se pas një muaji, në ditën e ardhshme të suksesit, sipas premtimit të bërë të sjellë me vete edhe një njeri tjetër...

“Po, do i mposhtim brazilianët...!”



“A guxoni të ëndëroni gjëra të mëdha?” – u shtroi pyetjen pjesëmarrësve të Takimit të **Menaxherëve** të mbledhur në çadrën e madhe të ngritur para Kështjellës së Szirakit drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** në përshëndetjen e tij. Si përgjigje publiku i madh i plotësuar me anëtarët e rajonit sllavo-jugor, në fillim heshtin si shenjë mirësjellje,

por me kalimin e kohës u entuaziazmua gjithmonë e më shumë. **“Mos shikoni shumë televizor, nëse dëshironi të dëgjoni lajme me të vërtetë të mira!”** – theksoi drejtori gjeneral. **“Natyrisht me përjashtim të programit të Televizionit-FLP, por këtë e dini. Ju lutem, tani më dëgjoni me vëmendje, sepse ju sjell lajme me**

të vërtetë të mira!”. Dhe me të vërtetë erdhën njëri pas tjetrit planet e bukura, idetë e realizuara, apo për t'u realizuar. Lajmet bënin fjalë rreth favoreve të blerësve, rinovimit dhe zgjerimit. U zgjerua Kështjella e Szirakit, është duke u rinovuar ndërtesa e rrugës Nefelejcs ku nëpërmjet kësaj mund të rritet niveli i trainimeve, pasi edhe pajisjet e rinovuara të

produkteve do të jenë më moderne. Do të zgjerohet trainimi-Sonya, dhe është në plan edhe krijimi i një qendre mësimore prej pesëqind personash në rrugën Nefelejcs. Gjithë kjo për t'u bërë akoma më të suksesshëm në ndërtimin e rrjetit. Në aspektin e sistemit MLM aktualisht jemi të tretët në botë, na e kalon vetëm Japonia dhe Brazili. Ky është



një rezultat i shkëlqyer dhe i respektueshëm, por të mos kënaqemi me kaq! T'ia vemë vetes si pikësynim që po, do i mposhtim brazilianët dhe do të bëjmë gjithçka për këtë. **"Guxoni të ëndërroni gjëra të mëdha! Përpara Hungari! Përpara FLP!"** – përmbloodhi fjalën e tij drejtori gjeneral Dr. Sandor Milesz.

Pas përshëndetjes erdhën tregimet e përvojave nga pjesëmarrësit e World Rally-t. Këtu mes të tjerëve ishte edhe diamant-safir menaxheri **Miklos Berkics**, diamant menaxherët nga Novisadi **Veronika dhe Stevan Lomjanski, disa anëtarë të President's Club**, dhe diamant-menaxherja e dyfishtë nga Gjermania **Katrin Bajri**. Qëllimi në çdo rast ishte entuziazmimi dhe ruajtja e dinamizmit. Shpeshherë bëjmë gabimin që gjatë ndërtimit të rrjetit tonë i harrojmë linjat e poshtme, bashkëpunonjësit e vjetër që e kanë treguar vetëveten – u dëgjua si vërejtje -, ndërkohë që ndihma dhe gjallërimi i punës së tyre është në interesin tonë. Përveç regjistrimit të punonjësve të rinj, është po aq e rëndësishme – apo edhe më e rëndësishme – ruajtja e marrëdhënieve me të vjetrit, koordinimi i veprimtarisë së tyre. Duhet t'i kushtojmë vëmendje kësaj,



duhet t'i dëgjojmë kërkesat e të sponsorizuarve tanë dhe t'u japim dorën nëse kanë nevojë për ndihmë.

"Pjesa zyrtare" u pasua nga atraksioni ndoshta më i shumëpritur i ditës, dreka në terren e cila u pëlqye nga të gjithë pjesëmarrësit. Sidomos

mishrat e pjekur dhe sallata e freskët ishin në listën e ushqimeve të preferuara.

- **Ju shijon dreka?** – pyes çiftin mjek safir menaxher të njohur, **Dr. Katalin Pirkhoffer** **Dr. Seresne dhe Dr. Endre Seres**, të cilët erdhën në Szirak





ndoshta më larg nga gjithë të tjerët. – Ushqimet janë shumë të shijshme dhe të shumëllojshme – përgjigjet Katalin, pastaj vazhdon – dhe ai që në mëngjes ndoshta harroi të konsumoj xhelin Aloe të zakonshëm, në restorantin e Kështjellës mund ta plotësonte atë. – **Edhe për Ju filloi herët dita e sotme?** – Për ne patjetër, pasi u nisëm nga Lenti, i cili është më shumë se treqind kilometra larg. – **Në këtë të shtunë është përvjetori i FLP-s, por siç e di, për ju**

edhe fundjava e rreshajës përmban një ngjarje të rëndësishme! – Po përgatitemi për festë – thotë me krenari Endre -, konkretisht për dasmën e djalit tonë Mate, i cili ndër të tjera është Menaxher këtu në FLP dhe punon në rajonin e Pecsit.

Pasditja u kalua në një atmosferë të shkëlqyer, në radhë të parë falë efektit të lojrave, muzikës dhe kërcimit. Këtu me të vërtetë argëtuam të gjithë. Sidomos loja çoço dhe demi rodeo i bënë për të qeshur pjesëmarrësit. Por këto

s'ia vlen t'i tregosh, më mirë shikoni xhirimet e bëra. Edhe ata që s'i pëlqejnë programet aktive, gjetën mundësinë më të mirë të shplohjes, pasi vizituan kështjellën, e cila s'ishte vetëm një eksperiencë artistike, por edhe një marketing i mirë, pasi Kështjella e Szirakit funksionon si një hotel ekskluziv, kështu që siguron për të gjithë një shplohje të pasur me aktivitete në çdo ditë të vitit.

Nga Aloe Lips i parë deri tek **medalja e diamantit**

Bisedë me Veronika dhe Stevan Lomjanskin

Veronika dhe Stevan Lomjanski – diamant menaxherë. Në ushtri do ishin gjeneral me shumë yje. Kjo është gradë, rendiment i shkëlqyer, madje gjithë kjo në Novisad të Serbisë të rënuar nga lufta dhe kriza.

- Duke njohur temperamentin e Veronikës supozoj se karriera juaj e FLP-s u nis kur në një ditë të bukur ajo tha: Stevan, nesër fillojmë punën!

- S'është aspak kështu, madje mund të them se ndodhi pikërisht e kundërta! – buzëqesh me modesti Stevan Lomjanski. Karriera jonë filloi në qershor të 1997-ës kur një i njohuri im nga Szegedi më ofroi këtë mundësi. Konstruktin klasik të MLM-s e njihnim dhe e kishim provuar, por duhet të them se në biznesin e fundit u zhgënjyem. Pavarësisht nga kjo më interesonte kjo gjë, sepse pashë sfidë tek ajo.

Prezantimin e parë e mbajtën lektorë mysafir, Laszlo Hari dhe gruaja e tij Marti, të cilët i prezantuan në mënyrë aq të përsosur produktet dhe planin marketing sa që ishte e pamundur të mos merreshe me të, megjithëse në atë kohë s'kishim as dy pikë.

- Por cila na e dha shtytjen e fillimit?

- Përvoja personale pozitive me produktet. Djali ynë atëherë kishte disa probleme të vogla, dhe erdhi menjëherë rekomandimi: të provojmë Aloe Lips. E provuam, pati efekt, madje shumë më të mirë se çdo gjë tjetër më parë.

- Deri tani s'e përmende emrin e Veronikës, si e pranoi ajo këtë mundësi të re?

- Si e pranoi? Në asnjë mënyrë! Në fillim as nuk donte të dëgjonte rreth saj. Nëse doja të thoja ndonjë fjalë që fillonte me shkronjën "A", më ndërpriste menjëherë, të pushoja sepse atë s'e bindja dot!

- Nuk u dëshpërove nga refuzimi?

- Po? – mendova me vete – do e shikojmë, pasi me ndihmën e Aloe Lips u zgjidhën problemet e djalit tonë, madje u parandalua edhe krijimi i tyre në të ardhmen, këtë s'e diskutoi as Veronika. E ngacmova vazhdimisht për dy muaj me radhë deri sa ra dakort.

- Dëgjova një leksion të Aranka Vagasit – hyn në bisedë Veronika – dhe thashë: Nëse vetëm dhjetë përqind e kësaj është e vërtetë, atëherë ia vlen! Shkuam në Budapest që të paguajmë çmimin e konviktit të djalit, por vendosëm që më mirë me këto para të blejmë paketën me produkte të fillimit dhe me këtë të fillojmë ndërtimin e biznesit.

- Djali juaj mendoj nuk e pranoi me shumë entuziazëm faktin që i thallamtumirë mësimi në Budapest?

- Pse, mendon s'e e lamë në baltë! Nga kursimet tona të fundit i paguam konviktin dhe fillim një punë intensive që të

bëjmë përsëri para. Ndërkohë me kalimin e kohës pamë se përse janë të dobishme produktet, shëndetin e sa njerëzve mund të ruajmë nëpërmjet tyre. I vumë vetes qëllim: meqë e filluam, do ta bëjmë deri në fund me ndershmeri!

- Në rregull, por vendi juaj atëherë ndodhej nën embargo, dhe natyrisht s'kishit as magazinë të produkteve FLP. Si e kapërcyët këtë pengesë?

- Mund ta imagjinoni se sa na e vështirësoi punën, por ne prapë u treguam këmbëngulës, e zhvilluam mëtej biznesin, sepse besonim në sukses dhe pamë një mundësi të madhe për ta ndryshuar rrënjësisht cilësinë e jetës sonë të deriatëherëshme. Çdo gjashtë muaj ngjisnim nga një shkallë në klasifikim dhe s'kishim akoma magazinë kur u bëmë safir menaxherë.

- Si e ndani punën mes njëri tjetrit?

- Që pas rezistencës së fillimit Veronika është motori, forca lëvizëse e biznesit tonë, merr përsipër detyra të shumta. Unë në radhë të parë duhet të kujdesem që të mos digjet, që të jetë gjithmonë në gjendje të rinovohet – shpjegon Stevan. Është shumë e rëndësishme edhe që kur kemi një problem të mos kërkojmë një tjetër, pasi me këtë vetëm humbasim kot energji, por të kërkojmë së bashku rrugëzgjdhje, sepse vetëm kjo na çon përpara. Kjo

është përgjigja e pyetjes tënde të mëparshme në lidhje me mungesën e magazinës.

- Një pyetje që duhet ta bëj patjetër, sepse u intereson shumë njerëzve: kujt ia dini për nder që pavarësisht nga rrethanat e shumta penguese të sipërpërmendura, jeni kaq të suksesshëm?

- Mbi të gjitha duhet të besojmë në vetvete që mund ta arrijmë qëllimin që i vumë vetes. Të mos mendojmë se vetëm të tjerët mund ta arrijnë, kurse ne jo, sepse ata janë më të zotë, më të bukur, më të aftë – kjo është marrëzi. Ai që ka një qëndrim të tillë, më mirë të mos e filloj. Të duam të ngrihemi mbi mesataren, të duam të jetojmë një jetë më cilësore se e deritanishmja, se mesatarja. Është shumë e rëndësishme edhe që të mos përipiqemi t'ia ofrojmë me forcë asnjëri produktet, të mos tregohemi të dhunshëm, sepse kjo shkakton automatikisht rezistencë nga tjetri. Ta prezantojmë me mjeshtëri mundësinë dhe efektin parandalues, pastaj të presim me durim derisa ta kërkoj ai vetë, sepse e kupton se ka nevojë për të! Atij i duhet. Ai e dëshiron, dhe vetëm atëherë do të funksionojë biznesi. T'i shtrojmë vetes disa pyetje: Përse? Me kë? Si? Kur? Dhe t'u japim këtyre përgjigjen e duhur: Sepse dua të jetoj një jetë më cilësore e të shëndetshme. Me ata që e duan njëlloj si unë. Me këmbëngulje, besim, angazhim,

Personalitet karizmatik dhe i shenjtë. Ai që e krijoi këtë koncept, ka menduar për atë. Nëse takohet me një shoqëri, rrethohet menjëherë nga njerëzit, sepse s'mund të mos i kushtosh vëmendje asaj. Në të njëjtën kohë e papërbalueshme nëse bëhet fjalë për punën, për Forever-in, sepse e realizon me çdo kusht atë që mendon. Shkëlqen si diamanti më i bukur. Pranë saj s'mund të mërzhitesh apo të rrish kot — thotë rreth Veronikës burri i saj Stevan -,

**por ai që ka besim tek ajo dhe e ndjek atë,
me siguri e arrin qëllimin.**

entuziazëm dhe jo nesër, por tani, menjëherë!

- Çfarë është ajo për të cilën jenë më shumë krenar gjatë punës suaj të deritanishme?

- Ta fillojmë me atë që kishim mesatarisht treqind pikë non-menaxheri në muaj deri në nivelin e diamantit. Falë kësaj u bëmë diamantët e parë dhe deri tani të vetëm në Europën Lindore. Kulmi ishte kur në shtator të 2005-ës **Gregg Maughan** erdhi nga Shtetet e Bashkuara në Beograd në mënyrë që përpara skuadrës serbe të na jap medaljen e diamantit, dhe këtë e konsiderojmë një respekt të madh të punës sonë. Dhe diçka tjetër që dua ta them me çdo kusht, sepse është e rëndësishme: falenderojmë FLP-n shumë korrekte që na dha ne këtë mundësi jo të zakonshme, dhe duhet të falenderojmë gjithashtu sponsorët dhe punonjësit tanë për sakrificën e tyre, pa të cilët ne s'do të bëheshim dot kaq të suksesshëm!

- Si përfundim, si arrini t'i motivoni njerëzit që përveç produkteve të shkëlqyera të ndërtojnë edhe biznes?

- Me çdo produkt kemi përvoja të shumta pozitive, por mendoj se produkti më i mirë është plani marketing. Mundësia e biznesit është fantastike, varet vetëm nga fakti që E DO APO NUK E DO. Rreth këtij qëndrimi më njohin në gjithë rajonin.



MLM

puna e të ardhmes



Mysafirët që erdhën në aktivitetin FLP Success Day të përvjetorit në muajin maj në sallën e madhe të Pallatit të Sindikatave u pritën nga aroma e këndshme e pragut të verës.

Rolin e drejtuesit të programit të festës e morrën distributorët më të suksesshëm të vendit, diamant menaxherët **Veronika dhe Stevan Lomjanski**. Çifti Lomjanski e përmirëson prej vitesh të tëra emrin e vendit tonë në gjithë botën e FLP-s. Është një krenari e madhe për ne, sepse në Europën Lindore ata ishin të parët që u bënë diamant menaxherë, dhe së bashku gëzuan për sukseset e reja të punonjësve tanë.

Punonjësit e pranishëm u përshëndetën nga drejtori rajonal i FLP Serbisë,

menaxheri **Branislav Rajić**. Kompania jonë funksionon në më shumë se 130 shtete të botës falë planit unik të biznesit, i cili u ofron miliona punonjësve mundësi për një jetë më të mirë e më cilësore. Drejtori rajonal Rajić prezantoi programet e reja motivuese që FLP paraqet së shpejti. Me këto programe kompania jonë u jep hapsirë akoma më të madhe mundësive me të cilat mund të sigurojmë kushte më të mira të ndërtimit të rrjetit dhe udhëtime të reja.

Me produktet FLP mund të luftojmë me efektivitet kundër

zakoneve të këqija, faktorëve të rrezikshmërisë, stresit, si dhe rreziqeve të tjera që dëmtojnë organizmin tonë. Leksioni i soaring menaxheres **Dr. Biserka Lazarević** tregoi se në ditët e sotme nuk ekziston mënyrë e shëndetshme jete-se pa plotësues ushqimor. Përdorimi i duhur dhe i përditshëm i këtyre siguron një efekt të shkëlqyer për përmirësimin e rrethanave të jetës, gjendjes psikofizike dhe të përgjithshme të organizmit, nëpërmjet të cilit bëhet edhe më efektive veprimtaria e përditshme.

Një nga pjesët më të rëndësishme të aktivitetit tonë merret me përvojat e mrekullueshme që fitojnë konsumatorët e FLP-s dhe punonjësit tanë mjek, të cilët gjatë punës së tyre rekomandojnë konsumimin e produkteve të FLP-s. Koha dhe cilësia punon në favor të produkteve FLP. Falenderojmë senior menaxherin **Dr. Olivera Miškić** i cili drejtoi këtë pjesë të programit dhe falë njohurive të tij të pasura me këshilla dhe rekomandime i pasuroi edhe më shumë përvojat e dëgjuaara me produktet.

Në skenën e Pallatit të Sindikatave përgëzuan punonjësit **supervisor, asistent menaxher** dhe **menaxher** të sapokualifikuar. Shpresojmë se së shpejti do t'i përshëndesim ata skenë në nivele edhe më të larta kualifikimi në krye të skuadrave të tyre.

U argëtuam me këngët e këngëtarit gjithmonë të ri të jetës muzikore serbe dhe drejtuesit të grupit „Galija”, **Neša Milosavljević**. Shijuan çdo moment të koncertit të këtij artisti dhe showman të shkëlqyer. Shpresojmë se Neša dhe grupi i tij t'i respektoj edhe në të ardhmen aktivitetet tona.

Në këto ditë të vështira ndërtimi i rrjetit marketing është ndër metodat më efektive me të cilat mund të kapërcejmë krizën ekonomike, u sigurojmë punë atyre që pushohen nga puna, u ofrojmë burime materiale gjithë atyre që dëshirojnë t'i sigurojnë këto në rrugë të ndershme, dhe u japim mundësinë e nisjes së biznesit



personal gjithë atyre që e dëshirojnë dhe e marrin përsipër këtë gjë. Lекtori mysafir **Branislav Maričić** ka siguruar përvoja të mëdha në ndërtimin e MLM, dhe gjatë punës së tij shumëvjeçare u bind se kjo është puna e të ardhmes. E falenderojmë Branislav-in që i ndau me ne përvojat e tij të pasura.

Sekreti i punës sonë fshihet në këmbënguljen e treguar në rrugën drejt suksesit. "Nëse mendoni për kërkesat dhe

dëshirat, fitoni entuziazëm dhe energji pozitive e cila iu shtyn përpara!" – tha në leksionin e saj senior menaxherja **Milena Petrović**. Shumë njerëz jetojnë në humnerën mes të kaluarës dhe të ardhmes, dhe nuk e shikojnë realisht se çfarë jep e tashmja. Ftesat, takimet, prezantimet dhe marrdhënit e punës sjellin rezultat të mirë vetëm nëse punojmë rregullisht, çdo ditë, me planifikim dhe me një pamje të qartë të ardhmeje.





Punonjësit më të suksesshëm të rajonit tonë, të cilët e rritën shumë qarkullimin e tyre në krahasim me periudhën e mëparshme, zonë me dinjitet vend mes anëtarëve të Klubit të Sundimtarëve. Përveç kësaj sivjet një numër i madh punonjësish serb shkon në Amerikë, në Super Rally-n ndërkombëtar të FLP-s të pëlqyer shumë.

Direktiva e çdo tregëtari të suksesshëm në rrugën drejt suksesit përbëhet nga

cikli i duhur i biznesit. Soaring menaxheri **Boro Ostojic** në leksionin e tij theksoi se besimi shumë i rëndësishëm në punë bazohet në materialet e edukimit dhe mësimin e duhur. MLM u zhvillua në një degë industrie që përmban mundësi të mëdha dhe kështu u bë puna e shekullit 21 për të gjithë ata që dëshirojnë pavarësi dhe duan të jenë të kënaqur, të lumtur dhe të pavarur materialisht.

Takimin Forever menaxher të Serbisë e organizojmë më 26

qershor në shtëpinë e pushimit të fshatit Babe, dhe një ditë më pas, më 27 takohemi me punonjësit tanë në Ditën e Suksesit të qershorit.

I përgëzojmë punonjësit tanë **asistent supervisor** të rinj për kualifikimin e tyre. Ju përhëndesim me kënaqësi në botën e biznesit Forever ku ju jepet mundësia e ndërtimit të rrjetit personal të punonjësve.

BRANISLAV RAJIC
Drejtori rajonal i FLP Serbisë

KLUBI I SUNDIMTARËVE

Dhjetë distributorët e parë të muajit maj 2009 sipas pikëve personale dhe të non-managerit



Hungaria

1. Vágási Aranka dhe Kovács András
2. Dr. Kósa L. Adolf
3. Bencsik Erzsébet
4. Zóka Margit
5. Klaj Ágnes
6. Hertelendy Klára
7. Utasi István dhe Utasi Anita
8. Erdei Zoltán dhe Erdei Ilona Etelka
9. Lopicz Tibor dhe Lopiczné Lenkó Orsolya
10. Bata Orsolya dhe Holló Szilárd

Serbia, Mali i Zi

1. Lomjanski Stevan dhe Lomjanski Veronika
2. Miškić dr. Olivera dhe Miškić dr. Ivan
3. Strboja Jovanka dhe Strboja Radivoj
4. Jelić Gordana dhe Jelić Siniša
5. Bajrušević Milica dhe Bajrušević Vuk
6. Kota Izabela Barbara dhe Kota Mihajlo
7. Buruš Marija dhe Buruš Boško
8. Jakupak Vladimir dhe Jakupak Nevenka
9. Mihailović Branko dhe Mihailović Marija
10. Radulović Rajko dhe Radulović Slavka



CONQUISTADOR CLUB



Kroacia

1. Jurović Zlatko dhe Jurović Sonja
2. Dr. Molnár László dhe Dr. Molnár-Stantić Branka
3. Korenić Manda dhe Korenić Ecio
4. Miljak Rill Ivanka dhe Rill Rolf
5. Stazić Julijana
6. Zantev Andrea
7. Golubović Karmela dhe Golubović Roman
8. Banić Nedjeljko dhe Banić Anica
9. Petrović Jasminka dhe Petrović Mirko
10. Matulić Nataša dhe Matulić Mladen

Bosnia-Hercegovina

1. Mustafić Subhija dhe Mustafić Safet
2. Franjić dr. Goran
3. Njegovanović Vasilije
4. Bahtić dr. Nedim
5. Njegovanović Grozdana dhe Njegovanović Sreten
6. Jovanović Radojka dhe Jovanović Žarko
7. Alagić Nevresa



Sllovenia

1. Batista Ksenja
2. Mavrić Tanja
3. Iskra Rinalda dhe Iskra Lučano
4. Zabkar Alain dhe Kević Zorana
5. Germek Marjana
6. Tonejc Saša
7. Sijanec Zdenka
8. Novak Jožica
9. Kegl Marija dhe Kegl Alojz

*"E dini se në jetë ekzistojnë vetëm dy ditë të cilat s'mund të ndryshohen aspak?
Njëra është e djeshmja, kurse tjetra është e nesërmja.
Vetëm në ditën e sotme mund të jetojmë, të veprojmë, të punojmë dhe
para të gjithave vetëm sot mund të jemi TË LUMTUR..."*



Atmosferë e shkëlqyer, fytyra të qeshura

Dita e Sukselit e paharueshme në Opatijan e mrekullueshme u mbajt në sallën e mbushur plot të hotelit "4 Opatijska cvijeta". Momenti i mbërritjes, rregullimi i sallës, numri i pjesëmarrësve, të gjitha këto treguan se kjo do të jetë një ditë e veçantë. Drejtimin e programit të Ditës së Sukselit e morrën përsipër menaxherët e sapokualifikuar **Silvana dhe Vigor Grbac**. Si hyrje, me një

film të shkurtër prezantuan vetveten, punën, sponsorët dhe punonjësit e tyre. Falenderuan të ardhurit nga gjithë zonat e vendit dhe mysafirët e ardhur nga vendet fqinje, duke theksuar mes tyre në mënyrë të veçantë safir menaxheren **Agnes Krizso**.

Programi u hap nga grupi Maestral që luan prej vitit 1985, i cili në këtë ditë u shfaq e përforcuar me skuadrën kërci-

mtare të pjesëmarrësve të Ditës së Sukselit.

Publiku u përshëndet me fjalë të ngrohta nga drejtori rajonal kroat **Dr. Laszlo Molnar**. Një atmosferë e shkëlqyer, është ndjenjë e mirë të shikosh fytyra të qeshura – e nisi përshëndetjen e tij drejtori Molnar, i cili përgëzoi në mënyrë të veçantë inteligjencën e Fiume Team. Thonë se bota ndodhet në recesion, ndër-

kohë që qarkullimi ynë filloi të rritet. Përshëndeti në mënyrë të veçantë të rinjtë që me mbështetjen e anëtarëve me përvojë të FLP-s përbëjnë të ardhmen e saj. U uroi të gjithëve argëtim të mbarë dhe marrjen e njohurive të shumta nga lektorët e shkëlqyer.

Dr. Tamara Kauzlaric Živković në leksionin e saj rreth lehtësisë së lëvizjes. Me të vërtetë nuk e kuptojmë se



sa e rëndësishme është edhe lëvizja më e vogël, derisa kjo për ndonjë shkak bëhet e dhimbshme. Gjimnastika, loja, ngarja e makinës – të gjitha këto kanë lidhje me lëvizjen. Lëvizjen e bën të mundur struktura e trupit tonë – kockat dhe muskujt. Nga leksioni mësuam se si është e mundur me një mënyrë të shëndetshme jetese dhe natyrisht me ndihmën e plotësuesve ushqimor dhe produkteve FLP të ruajmë lehtësinë e lëvizjes. Falenderojmë doktorëshën Tamara e cila në mënyrë të thjeshtë e të kuptueshme për të gjithë foli rreth anatomisë, sëmundjeve, parandalimit dhe mjekimit.

Drejtojuuni atij nëse keni nevojë për ndihmë, nëse doni të dini më shumë rreth produkteve. Ai zotëron njohuri të shumta dhe i ndihmon gjithmonë me kënaqësi nevojtarët.

“Me përcjelljen e njohurive tona pasurojmë të tjerët, ndërkohë që ne vet nuk humbasim. Përkundrazi: atë që japim, e marrim prapa”. Me këto fjalë ju drejtua të pranishmëve **Dr. Albert Kereszteni**. Përmendi të gjithë ata që ndodhen këtu në FLP që nga fillimi, ndërkohë që përshëndeti me përzemërsi ata që tani bashkohen me ne, pastaj ju lut atyre që dëshirojnë të ndajnë me ne përvojat e tyre që ta bëjnë atë, ai do t’u japë ndihmë.

Në vazhdim pasoi vlerësimi i rezultateve. Në **Business 20** u kualifikuan tre punonjës të rinj. Dhe me këtë përfundoi ky aksion i bukur.

Të bëhesh dhe të qëndrosh i suksesshëm – këtë titull i dha leksionit të saj senior menaxherja **Mande Korenić** e cila kishte ardhura nga Pula. Leksionin e saj e nisi me fjalë falenderimi: falenderoi gjithë menaxherët, sponsorët dhe punonjësit të cilët e ndihmuan të bëhej e



suksesshme. Varet vetëm nga vendimi ynë që a bëhemi të suksesshëm, asnjëri s’e bën këtë në vendin tonë. Qëllimi na motivon, kurse mjeti për arritjen e qëllimit sigurohet nga produktet. Kanë efekt motivues edhe shpërblimet dhe politika e shkëlqyer e biznesit. Dhe ashtu si kudo, edhe këtu është i rëndësishëm mësimi. Natyrisht duhet të punojmë, por marrim më shpejt dhe më shumë – mbylli fjalën e saj Manda.

Menaxherja **Sonja Jurović** në leksion e saj foli rreth rrugës që të ngjit përpjetë. Në bazë të përvojave të saj personale na bëri të njohur rrugën që të çon nga fillimi, konsumimi i produkteve, mbledhja e pikëve deri tek puna serioze që duket në llogaritë tona bankare. Nëse në këtë rrugë kemi partnerë që na ndihmojnë, suksesi është i pashmangshëm. Historia e Sonja-s dhe Zlatko-s është provë e gjithë kësaj. Mos humbisni

kohë në rrugë të ngushta, por na ndiqni, ne ju udhëheqim – përfundoi leksionin e saj Sonja.

Pasoi pjesa e dytë e kualifikimeve. Ishte një eksperiencë e mrekullueshme të shikoje shfaqjen në skenë të supervisorëve, asistent menaxherëve dhe menaxherëve. U dhanë gjithashtu edhe dy targat e programit të makinës. Konkurimi pozitiv ndikon mirë në përpjekjet për në majë.

Kur tre vjet më parë drejtuesit tanë erdhën në Ditën e Suksesit të Zagrebit, lektori i radhës i pyeti: përse prisni? Përse prisnin? Të bashkoheshin vullnetarisht me FLP-n. Dhe leksionin e tij rreth këtij bashkimi vullnetar dhe rreth punës të përgjegjshme, me kërkesën e shumë njerëzve, **Zsolt Pölhe** e përsëriti edhe në Opatija. Në këtë biznes asnjë segment nuk bëhet me sforcim. Në të njëjtën kohë kjo vullnetari s’është e njëjtë me përgjegjësinë, sepse





puna e papërgjegjshme s'jep rezultate. Ky ishte një leksion që të bënte të mendoheshe. Falenderojmë Zsolt-in që erdhi në Opatija.

Edhe gjërat më të mëdha në botë u krijuan në mënyrë të tillë që dikush kishte një ëndërr dhe pati guxim ta realizoj atë. Si t'i ndjekim ëndrrat tona – rreth kësaj bëri fjalë leksioni me temperament i senior menaxheres dhe anëtares së President's Club **Agi Krizso**. E shikojmë gjithmonë me kënaqësi atë që hodhi bazat e Fiume Team, por edhe ajo shkëlqen nga gëzimi kur shfaqet në Ditët e Suksesit. Njëlloj si lektorët tanë të tjerë edhe Agi u prek nga emocionet. Çdo moment i ditës së sotme rrezatoi bashkimin. I dhamë besim dhe ju gëzuar njëri tjetrit. Edhe Agnes e ndjeu energjinë dhe dashurinë e grumbulluar, dhe tha se së bashku mund të arrijmë më shumë. T'ia dimë për nder të gjithëve: punonjësve të zyrës dhe atyre distributor, lektorëve të Ditës së Suksesit dhe trainimeve, sepse këtu i përcjellim me sinqeritet njohuritë dhe përvojat tona, në mënyrë që ta arrijmë me të vërtetë atë që dëshirojmë. Punoni së bashku dhe ndihmoni njëri tjetrin. Vetëm kështu mund të realizohen ëndrrat.



Në fund të ditës drejtori **Dr. Laszlo Molnar** falenderoi në emrin e secilit prej nesh lektorët për leksionet e shkëlqyera, si dhe çiftin Grbac për drejtimin e shkëlqyer të programit. Pas kësaj në skenë thirri ata që u kualifikuan në nivelin e asistent supervisorit që të marrin medaljen e merituar të shqiponjës së artë.

Këtë ditë të mrekullueshme e mbyllëm me premtimin se përvjetorin e dhjetë të FLP Kroacisë në tetor do e festojmë gjithashtu në Opatija. Deri atëherë u urojmë të gjithëve suksese të shumta.



Mrsc. LASZLO MOLNAR
Drejtor rajonal

NJOFTIME

TË REJA

FLP Hungari Shpk bën gjithçka që ju të keni sukses në punë. Prandaj nga marsi i 2009-ës e ndryshojmë mënyrën e shpërndarjes së revistës FOREVER. Dëshirojmë që revista jonë të përfundojë sa më shpejt dhe menjëherë tek sa më shumë distributorë, prandaj nuk e postojmë sipas bonusave mujor, por me rastin e çdo blerje produktesh me vlerë pikësh japim falas edhe një revistë në çdo vend të rajonit tonë.

Shpërndarja e revistave të reja fillon në datën 15 të çdo muaji dhe zgjat deri në datën 14 të muajit të ardhshëm. Në vendet ku bëhen shitje pa vlerë pikësh natyrisht edhe në të ardhmen mund të blini revistat tona aktuale dhe më të vjetra.

FLP Hungari Shpk përpiqet vazhdimisht të përmirësojë efektivitetin e komunikimit me distributorët. Dëshirojmë t'ua dërgojmë më shpejt dhe më shpesh Juve informacionet.

Prandaj lutemi dhe rekomandojmë të regjistrohemi sa më shumë në listën tonë letërkëmbëse. Këtë mund ta bëni edhe nëse ua diktoni personalisht adresat tuaja E-mail punonjësve tanë në zyra, të cilët i shënojnë ato në sistemin tonë.

PROGRAME MOTIVUESE

Nga data 1 Prill 2009 fillon ALOE TRAVEL SERVICE (ATS), një klub udhëtimi i veçantë dhe ekskluziv. Distributorët anëtarë të këtij klubi mund të udhëtojnë me çmime 20-50% më të lira.

– Distributorët me 2 ose më shumë pikë mund ta blejnë **kartën e anëtarësisë** në zyrat vendase të FLP-s. Çmimi i anëtarësisë është 49 €/person/vit.

– Edhe partnerët tanë që s'kanë arritur akoma nivelin e asistent supervisorit mund ta blejnë kartën e anëtarësisë nëse më parë blejnë një paketë Travel Pack, vlera e pikëve e të cilës është 1,0550 cc.

– Për regjistrimin në klub duhet plotësuar një formular i thjeshtë ku shënohen të dhënat dhe **adresa e-mail** e distributorit.

– Distributori me kartën e anëtarësisë mund të regjistrohet në faqen e internetit të ATS, dhe me këtë bëhet anëtar online i klubit të udhëtimit.

– ATS jep ofertat e zgjedhura me 4, 5, 6 yje të agjensive të udhëtimit më të mëdha të Europës perendimore.

Mendojmë se anëtarët aktiv të këtij klubi e meritojnë që të marrin pjesë në udhëtime sensacionale me çmime speciale të siguruar nëpërmjet FLP-s.

Telefon: (+36-70) 434-3843

E-mail: register@aloetravel.com

RISPONSORIZIM

